




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Primaleno N°/Data			
17-05-2022			
Nr./ organit Org. broj	Numri/Drej	Shtabë Prilog	Vlera Vrednost
01-070	01-534		



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR NDRYSHIM PLOTËDIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS SË VITISË ME NR. 01-013/491 TË DATËS 21.04.2011

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Duke u bazuar në Nenin 6, pika 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, për vënien në konsultim publik Draft ndryshim plotësimi i Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, Zyra për Informim në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal të Vitisë, bën njoftimin për:

KONSULTIM PUBLIK

Njoftim publik për shpalljen në konsultim publik për draft ndryshimin e plotësimin të statutit të komunës së Vitisë me nr. 01-013/491 të datës: 21.04.2011

Të nderuar qytetarë të Komunës së Vitisë!

Ju njoftojmë se, në bazë të vendimit të lartpërmendur të Kuvendit Komunal i Vitisë, draft ndryshimi i plotësimin të statutit të Komunës së Vitisë me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, ka qenë në konsultim publik deri me datën 30.04.2022.

Debati Publik për këtë propozim dokument është mbajtur me datën 06.05.2022, në ora 10:00 në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, konkretisht në sallën e Kuvendi Komunal të Vitisë, dhe ka qenë i hapur për çdo qytetarë dhe grup të interesit publik. Gjithashtu komentet kanë mund të dërgohen në formë fizike pranë Objektivit të Zyrës së Kryetarit, konkretisht në Sekretarin e Kuvendit Komunal ose edhe në formë elektronike në email adresën: fatlum.demiri@rks-gov.net
Dokumentet që kanë qenë në konsultim publik mund të gjenden në këto vegëza:
Dokumenti bazë Statuti i deritanishëm i komunës së Vitisë mund t'a gjeni këtu:

1. <https://kk.rks-gov.net/viti/wp-content/uploads/sites/32/2022/04/Statuti-i-Komune-se-Vitise-2011.pdf>
1. Propozimet e komisionit komunal për ndryshimin e statutit i gjeni këtu:
<https://kk.rks-gov.net/viti/wp-content/uploads/sites/32/2022/04/Vendim-per-konsultim-publik-ndryshim-plotesimin-e-statutit-te-komunes-se-Vitise.pdf>

Me datën 06.04.2022, është bërë njoftimi në portalin Plus Televizion.

1. Konsultim publik Draft ndryshim plotësimi i Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, u publikua me datë: 05.04.2022 në ueb faqen e komunës së Vitisë, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/.../Statuti-i-Komune-se-Vitise...>

Në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna .

Me 05.04.2022 është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik Draft ndryshim plotësimi i Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011

**PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR NDRYSHIM PLOTËSIMI E STATUTIT
TE KOMUNES SE VITISE ME NR. 01-013/491 TË DATES 21.04.2011**

1. Publikimi në uebfaqe: <https://kk.rks-gov.net/viti/wp-content/uploads/sites/32/2022/04/Njoftim-publik-per-draft-ndryshimin-dhe-plotesimin-te-statutit-te-komunes-se-Vitise.pdf>
2. Publikimi facebook eshte vere ne datën 05.04.2022.

Me datën 06.04.2022 është publikuar njoftimi në wep të Plus Televizionin për mbajtjen e konsultimit për Draft ndryshimi i plotësimit të statutit të komunës së Vitisë me nr. 01-013/491 të datës: 21.04.2011.

Me datën 26.04.2022 është bërë ripublikimi i njoftimit për mbajtjen e konsultimit për Draft ndryshimin e plotësimit të Statutit të Komunës së Vitisë me Nr. 01-013/491 të datës: 21.04.2011.

1. Rikujtimi i publikuar në uebfaqe:
2. Rikujtimi i publikuar në facebookun e komunës:
https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=227904489461296&id=100067252380999

KONSULTIMI PUBLIK

Më datë: **06.05.2022** është mbajtur debati publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, qytetarët e ndryshëm.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegzen: <https://kk.rks-gov.net/viti/news/eshte-mbajtur-debati-publik-i-draft-ndryshimit-dhe-plotesimit-te-statutit-te-komunes-se-vitise/>

Konsultimin e shpalli të hapur Fatlum Demiri kryetar i komisionit për ndryshim plotësim të statutit.

Fatlum Demiri: Përshëndetje të gjithëve! Fillimisht dua t'iu falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje në këtë konsultim publik.

Ajet Sallahu: Përshëndetje të gjithëve! Unë propozoj që, emrat e fshatrave të cekun në Statut dhe të shtohet një fshat i ri, fshati Shushtë

Fatlum Demiri, kryetari i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: I nderuari z.Sallahu, në nenin 3 të statutit bazë thuhet që, territorin dhe kufijtë administrativ të Komunës së Vitisë janë të përcaktuara me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave dhe Ligji për Kadastër. Në komision kemi parapë të arsyeshëm që nga kjo arsyeje që janë të rregulluara me ligjet e cekur me lart mos t'i fusim në statut emrat e fshatrave.

Ibrahim Rama: Përshëndetje e nderuar të pranishëm! A ka ndonjë arsye, pse po ndahet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në dy drejtori, siç e prezantuat ju.

Fatlum Demiri, kryetari i komisionit për ndryshim plotësim të statutit: I nderuari z.Rama, janë disa arsye pse komisioni vlerëson, që kjo drejtori duhet të ndahet në dy drejtori si: zhvillimi ekonomik i komunës, rritja e buxhetit komunal, rritja e stafit në drejtori etj.

Ali Bajrami: Pyetje rreth ndryshim plotësimit të loges së komunës.

**PROCESVERBAL I KONSULTIMIT PUBLIK PËR NDRYSHIM PLOTËSIMI E STATUTIT
TE KOMUNES SE VITISE ME NR. 01-013/491 TE DATES 21.04.2011**

z.Arian Alidema, anëtar i komisioni për ndryshim plotësim te statutit: I nderuar z.Bajrami, ndryshimi dhe plotësimi i loges së komunës bëhet me vendim të veçantë të Kuvendit Komunal të Vitisë e jo me këtë ndryshim plotësim të statutit.

Burim Sadiku: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Falënderoj dhe përgëzoj komisionin për punën e bërë në ndryshim plotësim të këtij statuti.

Mustaf Mehmeti i cili e ka dërgu me shkrim komentin i cili kërkon që Zyra për Komunikim me Publikun të shkëputet nga Njësia e Demokratizimit dhe te trajtohet si njësi e veçantë ashtu siç përcaktohet me rregullore të qeverisë. Ndërsa kërkesa e Mustaf Mehmeti aprovohet nga komisioni dhe komisioni i kërkon nga këshilltarët komunal, që nenin 74, paragrafi 74.2 të Statutit Baze ta fshinë krejt nga statuti; dhe neni 74, paragrafi 74.1, shkronja g riformulohet Zyra për Komunikim me Publikun, sepse këtë e parasheh edhe rregullorja (QRK) NR. 27/2018 PËR SHËRBIMIN E KOMUNIKIMIT QEVERTAR ME PUBLIKUN

Fatlum Demiri: Atëherë, pasi që nuk keni diçka për të shtuar, ky konsultim publik përfundon. Ju faleminderit për kontributin tuaj!

Draft ndryshim plotësimi i Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011 pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në Web faqen e Komunës.

Konsultimi publik përfundoi në orën **10:40**.

Adresat të cilat u publikuan për të mbledhur komente janë: Fatlum.Demiri@rks-gov.net

Draft ndryshim plotësimi i Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, ka qenë në konsultim publik nga data: **05.04.2022** deri më: **06.05.2022**, por, se në email-et e zyrtarëve që kanë qenë publik dhe që janë caktuar për t'i pranuar komentet apo edhe sugjerimet lidhur me këtë dokument, nuk është pranuar një koment.

LISTAT E NËNSHKRIMEVE

Fatlum Demiri



Kryetar i komisionit për ndryshim plotësim të statutit